



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	05.09.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS/IK	5159	2022	117



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.647/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.647/2022 të datës 22.07.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë kundër Vendimit Nr.0529/2022 dhe Vendimit Nr.0530/2022 të datës 14.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 05.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.647/2022 e datës 22.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Vendimi me numër 0530/2022 i datës 14.07.2022 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të kthejë ankuesin në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e pagës nga data 14.07.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Me datë 14.07.2022, Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ka nxjerr Vendimin Nr. 0529/2022 për shfuqizimin e Vendimit Nr.107/2015 të datës 13.03.2015 me të cilin ankuesi ishte caktuar Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, ndërsa me vendimin pasues gjegjësisht Vendimin Nr.0530/2022 të datës 14.07.2022, Ministri i MPB-së ka caktuar Zëvendësues të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Ankuesi, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 22.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4239/2022 të regjistruar me shenjen A.nr.647/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.0529/2022 dhe Vendimit Nr.0530/2022 të datës 14.07.2022 të Ministrit të MPB-së, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se Ministri i MPB-së me nxjerrjen e Vendimit Nr.0529/2022 për shfuqizimin e Vendimit Nr.107/2015 të datës 13.03.2015 ka vepruar në mënyrë të gabuar dhe të kundërligjshme sepse sipas të njëjtit Vendimi Nr.107/2015 i datës 13.03.2015 prej vitesh nuk është në fuqi dhe si i tillë është i pa objekt, respektivisht shfuqizimi i tij është bërë *ipso jure* (automatikisht) e për rrjedhojë shfuqizimi i tij nuk prodhon (sipas ligjit) asnjë pasojë juridike pavarësisht se i njëjti është përdorur si bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit. Sipas ankuesit Vendimi Nr.107/2015, përveçse është i shfuqizuar automatikisht me rastin e nxjerrjes së vendimit për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i njëjti është shfuqizuar edhe sipas dispozitave të nenit 83 paragrafi 10 të Ligjit për Zyrtarët Publikë. Me tutje ankuesi thekson se edhe nën supozimin se Vendimi Nr.107/2015 do të ishte në fuqi, vendimi i kontestuar (vendimi me numër 0529/2022) është nxjerr në kundërshtim me nenin 58 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak se nga data 13.03.2015 deri tani kanë kaluar me tepër se shtatë (7) vite, ndërsa me dispozitat e nenit 58 paragrafi 2 të LPPA-së, përcaktohet se: *Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ.* Po ashtu ankuesi në ankesën e tij pretendon se vendimi i kontestuar (vendimi nr.0529/2022) është në kundërshtim edhe me nenit 47 (Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar), nenin 49 (Panevojshmeria e arsyetimit), nenin 51 (Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të një akti administrativ), dhe nenin 52 (Paligjshmëria e aktit administrativ) të ligjit në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ankuesi, po ashtu pretendon se edhe Vendimi Nr.0530/2022 i datës 14.07.2022 për caktimin e Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe pas konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe si i tillë ky vendim cenon drejtpërdrejtë të drejtat nga marrëdhënia e punës të ankuesit sepse sipas të njëjtit pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent do ta ushtroj Zëvendësuesi i caktuar me Vendimin Nr.0530/2022 të datës 14.07.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa më datë 05.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme, në përgjigjen në ankesë thekson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të ankuesit me arsyetimin se Vendimi Nr.107/2015 i datës 13.03.2015 për caktimin e ankuesit Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke ju referuar Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe Ligjit Nr.04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent. Po ashtu, ky i fundit pretendon se ankuesi nuk ka vendim për emërim ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, rrjedhimisht sipas organit të punësimit ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës me vendimet e kontestuar si në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4239/2022 të datës 22.07.2022 e regjistruar me shenjen A.nr.647/2022 të parashtruar nga ankuesi

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 18.02.2022; Vendimin me Nr.05/66 të datës 14.03.2012 për emërimin e ankuesit Kryeshf Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent; Vendimin me Nr. 107/2015 të datës 13.03.2015 për caktimin e ankuesit ushtrues detyre të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent; Vendimin me Nr.02/25 të datës 22.01.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.0529/2022 të datës 14.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.0530/2022 të datës 14.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Shkresë e ankuesit për Ministrinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme; Përgjigjen me numër Reference: 0539/2022 të datës 21.07.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme për ankuesin; Shkresën informuese të datës 21.07.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Plotësimin e ankesës të datës 24.08.2022; Kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 28.07.2022; Dëftesë për pranimin e dërgesës të datës 28.07.2022; Përgjigjen e datës 23.08.2022 nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i MPB-së për përfaqësuesin e ankuesit; Njoftimin e datës 03.07.2015; Raportin Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 02.07.2015; Emailin e datës 14.07.2017; Propozim për pikë për rend ditës të datës 09.07.2015 nga Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së për Zyrën e Kryeministrit; Deklaratën e pajtueshmërisë me rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011 të datës 09.07.2015; Propozim për pikë për rend ditës e datës 04.01.2018 nga Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së për Zyrën e Kryeministrit; Raportin Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; Deklaratën e pajtueshmërisë me rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011 të datës 04.01.2018; Vendimin për emërimin e ankuesit Drejtor i Menaxhimit të Emergjencave i datës 02.09.2009; Kontratën e Marrëdhënies së punës të datës 15.09.2009; Vendimin me numër protokoll 719 të datës 14.09.2010 për caktimin e ankuesit ushtrues detyre të Kryeshf Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent; Vendimin me numër Ref:65/2022 të datës 09.08.2022 për aprovim të kërkesës për qasje në dokumente publike; Transkriptin e mbledhjes së 25 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 22.01.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.07.2022;

Përgjigjen në anekse të datës 05.08.2022; Vendimin A.nr.399/2022 të datës 01.06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi Nr.01/08 i datës 12.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesën për opinion ligjor të datës 14.07.2022; Emailin e datës 07.06.2022 nga [] për [] Emailin e datës 01.06.2022 nga [] për [] Emailin e datës 31.05.2022 nga [] për [] Emailin e datës 31.05.2022 nga [] për [] Emailin e datës 31.05.2022 nga [] për [] Emailin e datës 17.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 17.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 13.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 13.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 13.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 16.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 16.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 16.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 18.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 18.08.2021 nga [] për [] Emailin e datës 17.08.2022 dhe 13.08.2021 nga [] për []

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të provave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku konstatoi se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi me Vendimin e datës 02.09.2009 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 15.09.2009 ishte emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa me Vendimin Nr.05/66 të datës 14.03.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i njëjti me datë 14.03.2012 ishte emëruar Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjent, me mandat tre (3) vjeçar, gjegjësisht deri me datë 14.03.2015. Ndërsa, me datë 13.03.2015, një dite para përfundimit të mandatit tre (3) vjeçar, me Vendimin Nr.107/2015 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi ishte caktuar Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me numër 0529/2022 të datës 14.07.2022 me të cilin është shfuqizuar Vendimi Nr.107/2015 i datës 13.03.2015, analizoj dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 83 paragrafi 10 ku është përcaktuar se: *Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendin punës, dhe rrjedhimisht Kolegji në kuptim të këtyre dispozitave ligjore konstatoi se hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtarët Publikë, me datë 09.07.2020, ka përbërë shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi Nr.107/2015 i datës 13.03.2015 me të cilin ankuesi ishte caktuar Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, është shfuqizuar sipas fuqisë së ligjit dhe në asnjë rrethanë ky vendim nuk ka mundur të prodhojë pasojë juridike pas datës 09.07.2020, andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit Vendimi Nr.0529/2022 i datës 14.07.2022 është i pa objekt dhe si i tillë nuk ka prodhuar pasojë juridike në raport me ankuesin.*

Kolegji i Këshillit, po ashtu nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me vendimin pasues, gjegjësisht Vendimin Nr.0530/2022 të datës 14.07.2022, ka caktuar [] Zëvendësues të Drejtorit të Përgjithshëm të []

Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, vendim ky me të cilin ankuesi pretendon se i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e tij e punës.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimit ankimor të ankuesit se Vendimi Nr.0530/2022 i datës 14.07.2022 për caktimin e Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, cenon të drejtat nga marrëdhënia e punës të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar shkresat e lëndës dhe rrjedhimisht ka gjetur se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, me datë 04.01.2018 përmes shkresës zyrtare me numër protokolli 005/2018 drejtuar Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, kishte kërkuar që në mbledhjen e Qeverisë të futet në rend të ditës propozimi për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjent. Se bashku me shkresën me numër protokolli 005/2015 të datës 04.01.2018 i njëjta kishte bashkangjitur edhe Deklaratën e Pajtueshmërisë me Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011, përmes të cilës kishte siguruar se propozimi për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjent ka kaluar në të gjitha fazat procedurale të parashikuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore.

Rrjedhimisht, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 25-të, të mbajtur me datë 22.01.2018, kishte nxjerr Vendimin Nr.02/25 me të cilin ka miratuar propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me emërimin e ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, vendim ky i cili sipas transkriptit të mbledhjes së Qeverisë ishte votuar në mënyrë unanime dhe nënshkruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës. Për pasojë sipas shkresave të lëndës ankuesi këtë pozitë të punës ka vazhduar të ushtroj në mënyrë të papenguar nga data 22.01.2018, fakt ky që vërtetohet edhe me Vendimin Nr.01/08 të datës 12.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin ankuesi në cilësinë e Kryeshefit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent ishte emëruar anëtar i Komisionit të Posaçëm për parandalimin e infeksionit Corona Virus Covid-19.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të aplikueshme në kohën e nxjerrjes së Vendimit Nr.02/25 të datës 22.01.2018, përkatësisht:

Rregulloren Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, neni 4 ku përcaktohej se: 1. Qeveria ushtron pushtetin e vet ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Qeverinë. 2. Qeveria me qëllim të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi: 2.1. merr vendime me propozimin e autoriteteve të larta të administratës shtetërore; 2.2 nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve; 2.3. diskuton probleme ose çështje të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në kuadër të kompetencave të veta; 2.4. vendosë për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të veta, si dhe 2.5. kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin tjetër në fuqi, dhe nenin 6 paragrafi 4, ku përcaktohej se: 4. Në zbatim të kompetencave të tij Kushtetuese, Kryeministri, mund: 4.3. Menjëherë, ose jo më vonë se në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, të kërkojë që Qeveria ta rishqyrtojë dhe ta ndryshojë vendimin e saj, nëse Kryeministri vlerëson se vendimi i marrë nga Qeveria mund të ketë pasojë të dëmshme. Zbatimi i këtij vendimi pezullohet derisa Qeveria ta trajtojë kërkesën e Kryeministrit.

Rregulloren Nr.09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 26 ku përcaktoj se: *Kur Kryeministri vlerëson se vendimi i marrë nga Qeveria mund të ketë pasoja të dëmshme, ai mund të përmbahet nga zbatimi i vendimit dhe menjëherë, ose jo në varësi se në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë të kërkojë që Qeveria ta rishqyrtojë dhe ndryshojë vendimin e saj.*

Kolegji i Këshillit në kuptim të dispozitave si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës vlerëson se ankuesi konsiderohet i emëruar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, për faktin se në rastin konkret janë zbatuar procedurat e përcaktuara të rekrutimit, dhe procedura e miratimit të propozimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe se aprovimi i emërimit të ankuesit ishte nënshkruar si rrjedhojë nga Kryeministri përmes Vendimit Nr.02/25 të datës 22.01.2018. Për pasojë Kolegji i Këshillit në shkresa të lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë se Kryeministri apo Qeveria e Republikës së Kosovës ka kontestuar ndonjëherë Vendimin Nr.02/25 të datës 22.01.2018 në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe nenit 26 të Rregullores Nr.09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, Kolegji i Këshillit vlerëson se Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 0530/2022 të datë 14.07.2022 për caktimin e Zëvendësues të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, ka dështuar të vërtetojë në mënyrë të plotë dhe të drejt gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material sepse nga shqyrtimi i vendimit të kontestuar si dhe duke u bazuar në shkresat e administruara të lëndës, rezulton se në rastin konkret nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet për përfundimin e marrëdhënies së punës të ankuesit në kuptim të nenit 59, 60, 61 dhe 62 ndërlidhur me nenin 2 paragrafi 3, neni 32 paragrafi 3 dhe nenin 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, dhe si rrjedhojë nuk janë plotësuar as kushtet ligjore për caktimin e zëvendësuesit të zyrtarit kryesor administrativ, të përcaktuara me nenin 18 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, kështu që Kolegji i Këshillit konstaton se vendimi i kontestuar me numër 0530/2022 i datë 14.07.2022 është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar Vendimin Nr.0530/2022 të datë 14.07.2022 dhe si rrjedhojë ka konstatuar se me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar nuk janë respektuar kërkesat ligjore sipas nenit 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar se: 1. Akti administrativ i shkruar përmban pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)....” respektivisht në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, Kolegji konstaton se vendimi në fjalë përbëhet vetëm prej pjesës hyrëse dhe

dispozitivit, kështu që i njëjti nuk përmban pjesën arsyetuese e cila do t'i mundësonte palës ta kuptoj aktin administrativ, rrjedhimisht vendimi i kontestuar nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar si dhe bazën ligjore për vendosje dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret. Andaj, nisur nga ky konstatim Kolegji i Këshillit vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin Nr.0530/2022 të datës 14.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme edhe në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstatimeve të dhëna si me lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit me qellim të kthimit të ligjshmërisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.647/2022

Avdyl Bekteshi


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj - Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.